



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.259/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK për shkak të kërcënimit gjatë ditës së votimit në komunën e Pejës, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.259/2017 e datës 12.06.2017 parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje

A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje në të cilën thekson se në qendrën e votimit në shkollën “7 shtatori” në fshatin Vitomiricë, komuna Pejë, subjekti politik AAK ka zhvilluar fushatë, jashtë shkollës, vendin e votimit dhe janë vërejtur duke bartur votues me makina. Pretenduesi i ankesës thekson se ky subjekt politik ka përdorur mjetet e kërcënimit ndaj Alban Rexhepaj, kryesuesit të vendvotimit dhe kërcënuesi ka qenë Vllaznim Përgjegjaj. Lidhur me këtë zyrtarët policorë kanë qenë dëshmitarë të ngjarjes e nuk kanë reaguar. Njëri nga policët me të cilën është identifikuar me numrin 4736. Sipas parashtruesit të ankesës është bërë cenim të përcaktimit të lirë të votuesve, si dhe e nenit 11.3 të Rregullës 09/2013, kërcënim serioz për procesin e votimit. Parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti politik AAK me fushatën dhe presionin ndaj votuesve dhe ka bërë shkelje të Kodit Penal dhe Rregullores përkatëse zgjedhore.

Lidhur me rastin në fjale PZAP-i e njofto edhe Policinë e Kosovës dhe kërkoi nga ata që të ndërmarrin veprime konkrete.

Në raportin e policisë të datës 13.06.2017 theksohet se lidhur me rastin në fjale zyrtarët policor të caktuar në ruajtjen e rendit publik por edhe për të mundësuar votim të qetë ishin aty që nga

fillimi i implementimit të planit operativ, mirëpo edhe përkundër kësaj nuk kane arritur qe te vërejnë këtë person se ka hyre në këtë qendër te votimit. Por me te marr ankesën është vepruar me njësitet tjera reaguese dhe menjëherë e kanë identifikuar personin ne fjale Vllaznim Pergjegjaj dhe mbi bazën e vendimit te Prokurorit Policia e Kosovës i njëjti është shoqëruar ne stacionin policor ne Pejë dhe është intervistuar nga ana e hetuesve rajonal por se nuk është iniciuar ndonjë procedure penale për shkak qe sipas hetuesve kishte vetëm shkelje te rregullores se brendshme.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi apo provë materiale e cila do ti vërtetonte pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim te nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar pretendimet ankimore. Paneli konstatoi se ankesa refuzohet, nuk është e vërtetuar asnjë pretendim i parashtruesit të ankesës nga raporti i policisë në rastin konkret po ashtu as parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 259/2017 më datën 13.06.2017



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.